



VENDIM

Nr. 147 Datë 07.12.2011

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIU DHEN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e ÇEZ Shpërndarje sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Vendosi :

1. Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 – 2014), do të jete **5 lekë/kWh**.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e CEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI